



Lajmet e Fundit: [Navigation icons]



16/05/2021

Fier – Policia ka goditur një tjetër rast të veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve, pas një hetimi disamujor

Policia ka goditur një tjetër rast të veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve, pas një hetimi disamujor. Sekuestrohet lëndë narkotike cannabis sativa dhe një armë gjahu pa leje, bie në pranga një shtetas, shpallet në kërkim një tjetër.

Në vijim të punës për parandalimin dhe ndëshkimin e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve, nga Komisariati i Policisë Fier, në bashkëpunim me Prokurorinë e Fierit, pas një hetimi disa mujor, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit P. H., 60 vjeç dhe u shpall në kërkim shtetasi Sh. H., 29 vjeç, banues në Gorishovë, Fier.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e këtyre shtetasve, u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale 2.2 Kg lëndë narkotike e dyshuar cannabis sativa, e përgatitur gati për shitje, një peshore elektronike dhe një armë gjahu pa leje.

Vijon puna për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për veprime të mëtejshme.

WhatsApp Share

Facebook Share

Twitter Share

LinkedIn Share

Email

◀ Korçë – Goditet një tjetër rast i shpërndarjes së drogave të forta, në doza të vogla. Sekuestrohen 23 doza me lëndë të dyshuar narkotike heroinë

Raporti i ngjarjeve për 72 orët e fundit, Policia e Shtetit ▶

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

> Arkiva

> Akademia e Sigurisë

> Ministria e Brendshme

> Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

> Interpol

> Europol

> Misioni PAMECA V

> SCPA

> Projekti Trivalent